



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.25**

**25 mars**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 381 datë 24.2.2011	Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions”, SA e “Sicpa Security Solutions” Albania, sh.p.k. për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave ..... 883
Ligj nr.10 383 datë 24.2.2011	Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë ..... 884
Ligj nr.10 384 datë 24.2.2011	Për disa ndryshime në ligjin nr.9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin” ..... 897
Ligj nr.10 385 datë 24.2.2011	Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ..... 898
Ligj nr.10 386 datë 3.3.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së NATO-s për Mirëmbajtjen dhe Furnizimin (NAMSA), për demontimin e municioneve” ..... 907
Ligj nr.10 387 datë 3.3.2011	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Europës për zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë dhe statusin e saj ligjor ..... 914
Vendim i KM nr.156, datë 2.3.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “El Er Energy” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Stojan”, të miratuar me vendimin nr.1107, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave ..... 918

**LIGJ**  
**Nr.10 381, datë 24.2.2011**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË  
FINANCEVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE “SICPA SECURITY  
SOLUTIONS”, SA E “SICPA SECURITY SOLUTIONS” ALBANIA, SHPK PËR  
PROJEKTIMIN, FINANCIMIN DIZENJIMIN, PRODHIMIN DHE NGRITJEN E NJË  
SISTEMI PËR EMETIMIN, SHPËRNDARJEN, GJETJEN DHE MONITORIMIN E  
PULLAVE FISKALE E TË PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Miratohet kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “Sicpa Security Solutions”, SA e “Sicpa Security Solutions” Albania, sh.p.k. për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6925, datë 15.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 383, datë 24.2.2011**

**PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi i ligjit**

Qëllimi i këtij ligji është vendosja dhe zbatimi i skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton statusin ligjor, strukturën, funksionet dhe veprimtarinë e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (më poshtë i quajtur Fondi), i cili menaxhon financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Fondi” është Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, i krijuar sipas këtij ligji.

2. “Persona ekonomikisht aktivë” janë të gjithë personat e punësuar, të vetëpunësuar, punëdhënësit dhe persona me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme e të paluajtshme dhe burime të tjera të krahasueshme.

3. “Persona ekonomikisht joaktivë” janë të gjithë personat, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga buxheti i shtetit ose burime të tjera, të përcaktuara me ligj.

4. “Persona të punësuar” janë të gjithë personat e punësuar nga një punëdhënës.

5. “Punëdhënës” janë të gjithë personat, fizikë ose juridikë, që punësojnë persona të tjerë dhe u paguajnë atyre shpërblimin për punën e kryer, sipas legjislacionit të punës.

6. “Të vetëpunësuar” janë të gjithë personat që punojnë për llogari të tyre, si artizanë, biznesmenë të vegjël, konsulentë, pronarët e vetëm të një biznesi, fermerë dhe të tjerë të ngjashëm me ta, sipas legjislacionit të punës.

7. “Kontribues” janë të gjithë personat, fizikë dhe juridikë, të detyruar t’i paguajnë kontribute Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij ligji, si punëdhënësit, punëmarrësit, të vetëpunësuarit dhe shteti.

8. “Përfitues” është personi, i cili ka të drejtë të përdorë shërbimet e kujdesit shëndetësor nën skemën e sigurimit të detyrueshëm ose të përfitojë rimbursimin e kostove të shërbimeve shëndetësore, sipas një kontrate sigurimesh shëndetësore të detyrueshme.

9. “Pagesat e drejtpërdrejta” janë pagesa që bëjnë përfituesit e sigurimeve shëndetësore të detyrueshme për paketat e shërbimeve shëndetësore, pavarësisht nga pagesat e kontributeve të skemës së sigurimeve shëndetësore të detyrueshme.

10. “Përrjashtime nga përfitimet” janë shërbime shëndetësore, barna, pajisje mjekësore, që nuk financohen nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, por tërësisht nga pacienti.

11. “Çmim” është pagesa monetare për dhënien e shërbimit të kujdesit shëndetësor.

12. “Paketa e përfitimit nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”, paketa standarde e përfitimit të shërbimeve shëndetësore, e cila përfshin shërbime shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor, të kujdesit spitalor, barna të rimbursueshme dhe për përdorim spitalor dhe materialet e konsumit mjekësor.

13. “Punonjës i papaguar i familjes” është anëtar i familjes që punon e bashkëjeton me të vetëpunësuarin dhe nuk ka ndonjë punësim tjetër.

## KREU II SIGURIMI I DETYRUESHËM I KUJDESIT SHËNDETËSOR

### Neni 4

#### **Sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor**

1. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor bazohet në kontributet e të punësuarve e të punëdhënësve të shtetit dhe në burime të tjera për persona të tjerë, siç parashikohet në këtë ligj, bazuar në parimin e solidaritetit.

2. Skema e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore synon në mbulimin e popullsisë në përfitim të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të financuara nga sektori publik dhe privat, në bazë të këtij ligji.

### Neni 5

#### **Personat e siguruar**

1. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Shqipëri, si:

- a) të punësuarit;
- b) personat e vetëpunësuar;
- c) punonjësit e papaguar të familjes;
- ç) persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

2. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e mëposhtme të personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj:

- a) personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- b) personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) personat e regjistruar si të papunë-punëkërkues në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- ç) shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë;
- d) fëmijët nën moshën 18 vjeç;
- dh) nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike;
- e) kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta.

3. Personat, që nuk përfshihen në pikat 1 e 2 të këtij neni, kanë të drejtë të bashkohen vullnetarisht me skemën e detyrueshme. Personat e siguruar vullnetarisht kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si personat, subjekte të sigurimit të detyruar, nëse përmbushin kushtin e periudhës pritëse

6-mujore nga data e regjistrimit dhe e derdhjes së kontributit deri në datën e lindjes së të drejtës për të përfituar.

4. Pas përfundimit të periudhës së sigurimit të detyrueshëm ose sigurimit vullnetar, personat që nuk përfshihen në kategoritë, për të cilat kontribuon shteti, duhet të regjistrohen pranë Fondit për sigurim vullnetar brenda 3 muajve. Për regjistrime të vonuara, periudha pritëse do të jetë 1 vit nga data e regjistrimit dhe e derdhjes së kontributit vjetor.

5. Këshilli administrativ, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit, miraton rregulloren e sigurimit vullnetar, si dhe kushtet dhe përmbajtjen e kontratave të sigurimit shëndetësor vullnetar.

#### Neni 6

### **Detyrimi për të paguar kontributet**

1. Punëdhënësit, për vete dhe të punësuarit e tyre, personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes janë përgjegjës për llogaritjen e saktë dhe për pagesën e kontributeve, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

2. Sigurimi shëndetësor vullnetar paguhet nga vetë personi, i cili lidh me Fondin kontratë sigurimi shëndetësor vullnetar.

3. Kontributet për personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji paguhet nga shteti.

4. Rregullat për mbledhjen e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

#### Neni 7

### **Baza për llogaritjen e kontributeve**

1. Baza për llogaritjen e kontributit është paga bruto e personit të siguruar deri në maksimumin e pesëfishit të pagës minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve në shkallë vendi.

2. Kontributi i shtetit për personat ekonomikisht joaktivë bazohet në konsumin për frymë të shërbimit shëndetësor, indeksuar me koeficientin e inflacionit. Konsumi për frymë për shërbimin shëndetësor përcaktohet nga Fondi dhe miratohet nga Kuvendi së bashku me miratimin e buxhetit vjetor.

3. Baza për llogaritjen e kontributit për punonjësit e vetëpunësuar është mesatarja ndërmjet pagës minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve.

4. Për sigurimet shëndetësore vullnetare baza e llogaritjes së kontributit është mesatarja ndërmjet pagës minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve.

#### Neni 8

### **Masa e kontributit**

1. Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4 për qind e bazës për llogaritjen e kontributeve sipas pikave 1, 3 dhe 4 të nenit 7 të këtij ligji.

2. Për të punësuarit, kontributet paguhet, në masën 50 për qind nga punëdhënësi dhe në masën 50 për qind nga i punësuari.

#### Neni 9

### **Mbledhja e kontributeve**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbledh kontributet për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor nga punëdhënësit, për punonjësit dhe të vetëpunësuarit dhe ia transferon ato Fondit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbledh dhe i transferon Fondit kontributet për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor të të vetëpunësuarve në bujqësi (fermerëve).

3. Fondi është përgjegjës për llogaritjen dhe mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shëndetësore vullnetare.

4. Fondi mbledh kontributin nga Buxheti i Shtetit për popullsinë ekonomikisht joaktive.

#### Neni 10

### **Paketa e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm**

1. Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

a) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike;

b) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private;

c) barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore.

2. Paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm hartohen duke përcaktuar:

a) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor dhe spitalet publike, të cilat paguhen për këtë shërbim nga sigurimi i detyrueshëm;

b) listën e barnave të rimbursueshme, si dhe masën e mbulimit të barnave të saj. Struktura e listës së barnave përcaktohet në bazë të listës së barnave themelore, sipas klasifikimit INN (principit aktiv të barit), të përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, si dhe në mbulimin e alternativës më të lirë;

c) listën e pajisjeve mjekësore, si dhe masën e mbulimit të tyre.

3. Përfshirja e shërbimeve shëndetësore në paketën e sigurimit të detyrueshëm mbështetet në kriteret e mëposhtme:

a) mjekësore: shkalla në të cilën shërbimi ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës në shmgangien e përkeqësimit të mëtejshëm të shëndetit dhe në rritjen e jetëgjatësisë;

b) ekonomike: raporti i kostos së efektivitetit të shërbimit dhe disponueshmëria e burimeve financiare të Fondit;

c) sociale: aftësia paguese e pacientit, disponueshmëria e shërbimeve dhe numri i përfituesve në raport me popullsinë.

4. Hartimi i paketave të shërbimeve bëhet nga komisione teknike, të përbëra nga ekspertë, të cilët përfaqësojnë, në mënyrë të barabartë, ndarjen e kriterëve në mjekësore, ekonomike dhe sociale. Përbërja nominative e komisioneve teknike caktohet nga këshilli administrativ i Fondit, sipas rregullave të përcaktuara në statutin e Fondit.

5. Këshilli administrativ i Fondit miraton projektin e paketave të propozuara nga komisionet teknike dhe ia dërgon Ministrit të Shëndetësisë për procedim pranë Këshillit të Ministrave. Paketa e propozuar shoqërohet nga një raport financiar i Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit për mundësitë e mbulimit financiar nga Fondi të shërbimeve të paketave të propozuara.

6. Miratimi i paketave të shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, paraqitur nga Ministri i Shëndetësisë dhe shoqëruar me raportin financiar të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 11

### **Pagesat e drejtpërdrejta**

1. Personat e siguruar marrin pjesë në pagesën e një pjese të çmimit të shërbimit shëndetësor që u jepet. Masa, shërbimet dhe mënyra e pagesës së drejtpërdrejtë vendoset në çdo rast nga Këshilli i Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave, në bazë të politikave sociale të Qeverisë, mund të përjashtojë nga pagesat e drejtpërdrejta kategori të veçanta të individëve, duke u bazuar në aftësinë e tyre për të paguar.

Në këto raste, Këshilli i Ministrave jep fonde ekstra (subvencione) për t'u financuar dhënësve të shërbimeve shëndetësore koston e pagesave të drejtpërdrejta.

#### Neni 12

### **Shërbimet shëndetësore të cilat nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor**

1. Fondi i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor nuk financon shërbime të kujdesit shëndetësor ndaj personave që nuk janë të siguruar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të rasteve të urgjencës mjekësore.

2. Fondi i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor nuk financon shërbime të kujdesit shëndetësor që nuk bëjnë pjesë në paketat e shërbimeve të përcaktuara sipas këtij ligji.

#### KREU III

### **DREJTIMI I FONDIT DHE FUNKSIONET E ORGANEVE DREJTUESE**

#### Neni 13

### **Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor**

1. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është i vetmi person juridik, publik, autonom, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Buxheti i Fondit miratohet si pjesë përbërëse e pandarë e Buxhetit vjetor të Shtetit.

#### Neni 14

### **Statuti i Fondit**

1. Fondi organizohet dhe funksionon në bazë të statutit të Fondit, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave.

2. Statuti i Fondit përcakton, ndërmjet të tjerave:

a) strukturën e përgjithshme organizative të Fondit, funksionet dhe përgjegjësitë përkatëse;

b) procedurat e miratimit e të ndryshimit të rregullave procedurale për veprimtarinë e këshillit administrativ, Drejtorinë e Përgjithshme dhe zyrat vendore;

c) marrëdhëniet ndërmjet këshillit administrativ, Drejtorit të Përgjithshëm dhe zyrave vendore;

ç) procedurat për hartimin, ndryshimin dhe zbatimin e rregulloreve administrative, rregulloreve të organizimit dhe të personelit, rregulloret ekonomike, të auditimit dhe të kontabilitetit, si dhe procedura e rregullore të tjera, të nevojshme për veprimtarinë e Fondit;

d) masën e shpërblimit për pjesëmarrjen e anëtarëve në këshillin administrativ;

dh) marrëdhëniet ndërinstucionale brenda dhe jashtë vendit;

e) kriteret ligjore dhe profesionale të përzgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm.

#### Neni 15

### **Organet drejtuese**

Fondi drejtohet nga:

a) këshilli administrativ;

b) Drejtori i Përgjithshëm.

## Neni 16

### **Këshilli administrativ**

1. Këshilli administrativ është organi më i lartë vendimmarrës i Fondit dhe ka në përbërje 9 anëtarë, si më poshtë:

- a) Ministrin e Shëndetësisë ose përfaqësuesin e tij;
- b) Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e tij;
- c) Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ose përfaqësuesin e tij;
- ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Fondit ose përfaqësuesin e tij;
- d) Drejtorin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore ose përfaqësuesin e tij;
- dh) një përfaqësues të sindikatës së të punësuarve;
- e) një përfaqësues të dhënësve të kujdesit shëndetësor, i caktuar nga Urdhri i Mjekut;
- ë) një përfaqësues të shoqatës së punëdhënësve privatë dhe të të vetëpunësuarve;
- f) një përfaqësues të organizatës së konsumatorëve, të cilët përfaqësojnë përfituesit e Fondit.

2. Koha e shërbimit të anëtarëve të këshillit administrativ është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje, ose për atë kohë sa anëtari është përfaqësues i organit përkatës.

3. Këshilli i Ministrave përcakton se cila sindikatë, organizatë e personave të vetëpunësuar dhe punëdhënësve, organizatë konsumatore është përfaqësuesja më e madhe dhe që do të emërojnë përfaqësuesit e tyre në këshillin administrativ.

## Neni 17

### **Drejtimi i këshillit administrativ**

1. Këshilli administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin ndërmjet përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave.

2. Mandati i kryetarit të këshillit administrativ është njëvjeçar dhe bazohet në parimin e rotacionit.

3. Këshilli administrativ zgjedh nënkryetarin ndërmjet përfaqësuesve të kontribuesve joqeveritarë.

4. Kryetari ose, në mungesë të tij, nënkryetari drejton këshillin administrativ.

## Neni 18

### **Mbledhjet dhe vendimet e këshillit administrativ**

1. Mbledhjet e zakonshme të këshillit administrativ thirren nga Drejtori i Përgjithshëm, jo më pak se një herë në dy muaj.

2. Rendi i ditës propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga këshilli administrativ.

3. Këshilli administrativ mbledhet në mënyrë të jashtëzakonshme nga kryetari, me kërkesën e të paktën 3 anëtarëve të këshillit ose të Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Kuorumi i mbledhjeve të zakonshme është 2/3 e anëtarëve të këshillit. Vendimet miratohen me shumicën e anëtarëve të pranishëm. Gjatë votimeve në këshillin administrativ nuk lejohet abstenimi.

5. Në raste të jashtëzakonshme, sipas rregullave të brendshme të këshillit, kryetari mund të mbledhë këshillin dhe mbledhjet mund të zhvillohen me një kuorum prej 5 anëtarësh. Në këto raste, vendimi merret në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

6. Kryetari i relatton këshillit administrativ dhe paraqet për miratim vendimet e marra në raste të jashtëzakonshme, në mbledhjen më të parë të radhës.



Neni 19  
**Drejtori i Përgjithshëm**

1. Këshilli administrativ emëron Drejtorin e Përgjithshëm pas një procedure konkurrimi të hapur, në bazë të kritereve të përcaktuara në statutin e Fondit. Kandidatët duhet të demonstrojnë se kanë njohuritë dhe përvojën profesionale për të menaxhuar Fondin.

2. Drejtori i Përgjithshëm përzgjidhet nga këshilli administrativ nga një listë me jo më pak se tre kandidatë, që plotësojnë kriteret.

3. Këshilli zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm, me votim të fshehtë, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit administrativ.

4. Koha e ushtrimit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm është 5 vjet.

5. Paga e Drejtorit të Përgjithshëm caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Drejtori i Përgjithshëm raporton para këshillit administrativ.

7. Këshilli administrativ vendos për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm në këto raste:

a) nëse dënohet me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

b) nëse shkel dispozitat e statutit, vendimet e këshillit administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 20  
**Funksionet e këshillit administrativ**

Këshilli administrativ kryen funksionet e mëposhtme:

a) zgjedh, emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm për shkaqe të parashikuara në këtë ligj;

b) cakton anëtarët e komisionit teknik, sipas nenit 10 të këtij ligji, për hartimin e paketës së shërbimeve shëndetësore dhe të listës së barnave të rimbursueshme;

c) miraton paketat e shërbimit që financohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, të hartuara nga komisioni teknik, të cilat i dërgon në Ministrinë e Shëndetësisë për procedim pranë Këshillit të Ministrave;

ç) miraton rregullat ekonomike e financiare, procedurale, të kontrollit, strukturën e përgjithshme organizative dhe rregullat e personelit, si dhe rregulla të tjera të brendshme, që ai i gjykon të nevojshme gjatë veprimtarisë së Fondit, në zbatim të këtij ligji;

d) miraton kriteret e lidhjes së kontratave, si dhe kontratat me dhënësit e shërbimeve shëndetësore publike dhe private;

dh) miraton raportin vjetor, raportin financiar dhe bilancin vjetor, të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm;

e) miraton projektbuxhetin vjetor të Fondit dhe parashikimin për tre vitet e ardhshme;

ë) miraton sistemin e pagave të punonjësve të Fondit;

f) miraton hapjen ose mbylljen dhe shpërndarjen e zyrave vendore të Fondit;

g) përcakton numrin e përgjithshëm të punonjësve të Fondit, të cilin e dërgon për miratim në Këshillin e Ministrave;

gj) rekomandon ndryshime në legjislacionin e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor dhe ia propozon Ministrin të Shëndetësisë;

h) vendos për çështje të tjera, të parashikuara me ligj.

Neni 21  
**Funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm kryen funksionet mëposhtme:

a) propozon për miratim në këshillin administrativ statutin, rregulloren organizative, rregulloren e personelit, rregulloret ekonomike, rregulloret procedurale, raportin vjetor dhe projektbuxhetin vjetor;

- b) drejton veprimtarinë e Fondit, në përputhje me statutin dhe rregulloret e miratuara nga këshilli administrativ;
  - c) propozon në këshillin administrativ numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe miraton strukturën e brendshme dhe përshkrimet e punës të Drejtorisë së Përgjithshme e të zyrave vendore;
  - ç) emëron e shkarkon personelin dhe i propozon këshillit administrativ pagat e tyre;
  - d) propozon në këshillin administrativ politikat e zhvillimit të skemës së sigurimeve shëndetësore;
  - dh) përfaqëson Fondin në marrëdhëniet juridike me të tretët, mediat, si dhe në komunikimin me personat e siguruar dhe dhënësit e shërbimit shëndetësor;
  - e) zbaton vendimet e këshillit administrativ dhe raporton para tij për veprimtarinë e vet;
  - ë) u delegon kompetencat zyra vendore të Fondit;
  - f) zbaton detyra të tjera që i ngarkon këshilli administrativ.
2. Drejtori i Përgjithshëm mund të kërkojë këshillime nga specialistë të jashtëm për çështje që kanë të bëjnë me njohuri të veçanta.

#### Neni 22 **Raportimi**

1. Drejtori i Përgjithshëm përgatit raportin vjetor për financën, administrimin, kontraktimin, paketën e shërbimeve shëndetësore dhe popullsinë e mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, të cilin e paraqit në këshillin administrativ.
2. Këshilli administrativ përgatit një raport vjetor për Ministrin e Shëndetësisë.
3. Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet kërkesave specifike të informacionit për pjesën e buxhetit, që financohet nga Buxheti i Shtetit, që mund të kërkojë Ministria e Financave gjatë vitit.

#### KREU IV FINANCIMI I FONDIT

##### Neni 23 **Burimet e financimit**

- Fondi ka burimet e financimit si më poshtë:
- a) kontributet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji;
  - b) kontributin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor prej Buxhetit të Shtetit nga personat ekonomikisht joaktivë, sipas pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji;
  - c) kontributet e sigurimit shëndetësor vullnetar, sipas pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji;
  - ç) transfertat nga Ministria e Shëndetësisë për subvencionimin e një pjese të pagesave të drejtpërdrejta, sipas pikës 2 të nenit 11 të këtij ligji;
  - d) transfertat nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet e kërkuara nga ajo, përtej atyre të buxhetuara ose të kontraktuara nga Fondi;
  - dh) transfertat e miratuara në Buxhetin e Shtetit për balancimin e buxhetit të Fondit ose për kompensimin e mosrealizimit të kontributeve në procesin e zbatimit të buxhetit.
  - e) burime të tjera, dhurime, grante nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.

##### Neni 24 **Struktura financiare e Fondit**

1. Struktura financiare e Fondit është si më poshtë:
  - a) sigurimi i detyrueshëm shëndetësor përfshin të gjitha të ardhurat nga kontributet, burimet e tjera, sipas nenit 23 të këtij ligji, të ardhurat nga fondi rezervë, si dhe shpenzimet për pagesën e paketave të shërbimeve të kujdesit shëndetësor nën skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor;
  - b) fondi rezervë i sigurimeve të detyrueshme përbëhet nga tepricat e akumulueshme të të ardhurave ndaj shpenzimeve. Fondi rezervë është një fond emergjence për mbulimin e lëvizjeve të

përkohshme dhe të deficiteve operative në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me rregullat e përcaktuara për këtë qëllim me vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi rezervë nuk duhet të kalojë 10 për qind të shpenzimeve vjetore të Fondit;

c) administrimi përfshin shpenzimet korrente dhe kapitale për menaxhimin e Fondit;

ç) sigurimi shëndetësor vullnetar, i cili konsiston në të ardhurat dhe shpenzimet nën kontratat e sigurimeve shëndetësore.

2. Mjetet monetare të Fondit depozitohen në banka të licencuara dhe të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 25

#### **Aftësia paguese e Fondit**

1. Fondi menaxhon veprimtaritë e tij brenda burimeve të vlefshme financiare dhe nuk hyn në borxhe.

2. Fondi nuk mbulon shërbime të kujdesit shëndetësor jashtë paketës së sigurimit të detyrueshëm dhe jashtë kontraktiveve përkatëse.

#### Neni 26

#### **Kontabiliteti dhe auditimi**

Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### KREU V

#### PROCEDURAT

#### Neni 27

#### **Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar**

1. Të gjithë personat e përmendur në nenin 5 të këtij ligji janë të detyruar të regjistrohen te Fondi.

2. Punëdhënësit janë përgjegjës për regjistrimin te Fondi të punëmarrësve të tyre dhe për informimin e Fondit për:

a) numrin e personave që kanë siguruar;

b) emrat e personave të siguruar dhe numrin e sigurimit;

c) pagat e personave të siguruar;

ç) masën e kontributit të personave të siguruar;

d) periudhën e punësimit.

3. Të gjithë personat e regjistruar kanë një numër të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm dhe një dokument që vërteton regjistrimin e tyre në Fond e që identifikon personin e siguruar.

4. Personat, subjekt i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm, regjistrohen në Fond brenda 30 ditëve nga data që bëhen subjekt i detyrimit për të paguar kontribute. Ndryshimet në statusin e personave të siguruar regjistrohen dhe evidentohen nga Fondi.

5. Këshilli i Ministrave përcakton institucionet publike përgjegjëse dhe periudhën gjatë së cilës kanë detyrim për të informuar Fondin për numrin dhe identitetin e personave, sipas kategorive të përmendura në nenin 5 të këtij ligji.

6. Këshilli i Ministrave vendos rregullat për regjistrimin dhe identifikimin e të siguruarve dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit.

#### Neni 28

#### **Identifikimi i të siguruarve**

Identifikimi i personave të siguruar bëhet nëpërmjet dokumentit të identifikimit të sigurimit shëndetësor, të lëshuar nga Fondi.

## Neni 29 Kontratat

1. Fondi paguan dhënësit e shërbimeve shëndetësore vetëm për shërbimet e ofruara ndaj personave të siguruar dhe në bazë të termave e të kushteve të përcaktuara në kontratat përkatëse.

2. Këshilli administrativ miraton procedurat dhe kriteret për lidhjen e kontratave dhe për pagesat, duke synuar në stimulimin e aksesit ndaj shërbimeve, kostos së efektivitetit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara prej dhënësve privatë dhe publikë ndaj komunitetit.

3. Fondi lidh kontratë me dhënësit publikë të shërbimit shëndetësor, të licencuar nga autoriteti kompetent, dhe mbulon të gjitha shërbimet e ofruara nga dhënësi, të cilat janë të përfshira në paketën e shërbimeve, sipas nenit 10 të këtij ligji.

4. Fondi mund të lidhë kontratë me dhënësit privatë të shërbimit shëndetësor, të licencuar nga autoriteti kompetent. Kontrata përcakton shërbimet shëndetësore, që do të mbulohen nga Fondi. Kontratat lidhen për një kohëzgjatje të caktuar dhe mund të rinovohen.

5. Fondi ndërpret kontratën me një dhënës shërbimi në rastet kur analiza e performancës tregon se ky dhënës nuk përmbush kriteret, sipas pikës 2 të këtij neni. Përpara ndërprerjes së kontratës, Fondi duhet të informojë Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe t'i caktojë ofruesit të shërbimit një afat të caktuar kohe, brenda të cilit ai duhet të plotësojë kriteret.

6. Fondi krijon Regjistrin e Dhënësve të Përzgjedhur të Shërbimeve Shëndetësore, në të cilin regjistrohen dhënësit e shërbimeve publike, si dhe ato private, të cilët plotësojnë kriteret e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Regjistri i Dhënësve të Përzgjedhur të Shërbimeve Shëndetësore miratohet nga këshilli administrativ dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Fondit.

## Neni 30 Pagesat ndaj dhënësve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor

1. Këshilli administrativ përcakton dhe vendos format e ndryshme të pagesave ndaj dhënësve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke garantuar aksesin e popullatës ndaj shërbimeve, koston e efektivitetit të shërbimeve dhe rritjen e cilësisë së tyre.

2. Fondi paguan dhënës shërbimi të kontraktuar, për shërbime shëndetësore dhe barna e produkte mjekësore, të përfshira në paketat e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore, të dhëna në përputhje me termat dhe kushtet e kontratave të nënshkruara prej tyre me Fondin.

3. Fondi rimbursos personat e siguruar, që marrin shërbime nga dhënësit e shërbimit shëndetësor brenda vendit, që nuk kanë kontratë me Fondin, vetëm në mungesë të dhënësve të kontraktuar të shërbimeve shëndetësore, pas verifikimit përkatës nga Fondi. Këshilli administrativ specifikon rastet e rimbursimit të personave të siguruar, si dhe rregullat e procedurat e rimbursimit.

4. Fondi ka të drejtë dhe detyrë të verifikojë çdo pagesë të dhënë në përputhje me termat dhe kushtet e kontratave dhe të refuzojë çdo kërkesë për pagesë në rastet e parashikuara në rregulloret financiare, të miratuara nga këshilli administrativ.

5. Pagesa e shërbimeve të dhënësve të shërbimit shëndetësor bëhet vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

6. Zyrat vendore të Fondit paguajnë rregullisht, në përputhje me termat dhe kushtet në kontratat përkatëse, kërkesat e pagesave të dërguara prej dhënësve të kontraktuar të shërbimeve shëndetësore, pas verifikimit përkatës.

7. Procedura për paraqitjen e kërkesës për pagesë dhe verifikimi i tyre përcaktohen në rregulloret e hartuara nga Drejtori i Përgjithshëm dhe të miratuara nga këshilli administrativ.

## Neni 31 Verifikimi i kërkesave për pagesë

1. Fondi ka të drejtë dhe detyrë të verifikojë vërtetësinë dhe rregullsinë e çdo kërkesë për pagesë të dhënësit të shërbimit shëndetësor, përpara se të kryejë pagesën.

2. Në rast të kërkesave për pagesë, që konsiderohen të tepërta apo jo të rregullta, pagesa pezullohet deri në qartësimin ose korrigjimin e tyre. Në të kundërtën pagesa refuzohet.

3. Procedurat e verifikimit dhe të kontrollit të kërkesave për pagesë përcaktohen në rregulloret e hartuara nga Drejtori i Përgjithshëm dhe të miratuara nga këshilli administrativ.

## KREU VI SISTEMI I INFORMACIONIT

### Neni 32

#### **Detyrimi i autoriteteve publike për të dhënë informacion**

1. Fondi merr informacion nga Ministria e Financave për treguesit e zhvillimit makroekonomik, të dhënat për prodhimin e përgjithshëm bruto dhe informacione të tjera financiare për funksionimin e Fondit.

2. Fondi merr informacion nga Ministria e Shëndetësisë për politikën, strategjitë që kanë lidhje me sistemin shëndetësor, për të dhënat e gjendjes shëndetësore, si dhe informacione të tjera shëndetësore që kanë lidhje me funksionimin e Fondit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i jep informacion periodik Fondit për shumën e kontributeve të mbledhura të sigurimeve shëndetësore nga të gjitha subjektet që janë të detyruara të derdhin kontribute pranë kësaj drejtorie, për numrin e kontribuesve dhe listëpagesat përkatëse.

4. Këshilli i Ministrave përcakton institucionet ose organizmat e tjerë që duhet të ofrojnë të dhëna rregullisht, sipas nevojave të Fondit.

5. Fondi lidh marrëveshje ndërinstitucionale për shkëmbimin, në mënyrë të vazhdueshme, të informacionit të hollësishëm me entet private dhe publike, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, duke marrë dhe duke analizuar informacionin e tyre.

### Neni 33

#### **Detyrimi i raportimit të dhënësve të kontraktuar të kujdesit shëndetësor**

1. Dhënësit e shërbimit shëndetësor janë të detyruar t'u dorëzojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Fondit, periodikisht, informacion për veprimtarinë e tyre, sipas detyrimeve për raportim, të parashikuara në kontratat me Fondin.

2. Mosraportimi i pajustificuar si më sipër përbën shkak për zgjidhjen e kontratës dhe heqjen e dhënësit të shërbimit shëndetësor nga Regjistri i Dhënësve të Përzgjedhur të Shërbimeve Shëndetësore për një periudhë kohe të caktuar, nga këshilli administrativ, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

### Neni 34

#### **Konfidencialiteti i informacionit**

I gjithë informacioni për shëndetin e një personi të siguruar, i mbledhur dhe i transferuar në Fond, është konfidencial. Fondi administron informacionin e krijuar sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjisllacionin në fuqi, veçanërisht legjisllacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

### Neni 35

#### **Informimi publik**

1. Fondi ka detyrim ligjor të informojë publikun e gjerë periodikisht nëpërmjet mjeteve të shtypit, website-eve, revistave e broshurave, të publikuara prej tij, dhe mjeteve të tjera të komunikimit publik, për:

- a) vendimet e marra, në zbatim të këtij ligji;
- b) veprimtarinë e Fondit;

- c) paketat e përfitimit;
- ç) pagesat e drejtpërdrejta dhe tarifat.

2. Fondi përgatit dhe publikon një raport vjetor të veprimtarive të tij të përgjithshme, për popullsinë dhe shërbimet e mbuluara, si dhe financat e tij.

### Neni 36 **Statistikat**

1. Fondi përpilon statistikat e nevojshme për sa i përket zhvillimit të shpenzimeve të sigurimeve shëndetësore. Ofruesit janë të detyruar t'i shpërndajnë informacionin e nevojshëm Fondit. Fondi respekton legjislacionin përkatës për mbrojtjen e të dhënave.

2. Fondi publikon një raport statistikor vjetor.

### KREU VII **SANKSIONE**

#### Neni 37 **Sanksionet lidhur me kontributet**

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë veprë penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- a) mosregjistrimi ndëshkohet me gjobë me 25 000 lekë për çdo shkelje;
- b) vonesat e punëdhënësve në pagesën e kontributeve ndëshkohen me gjobë të barabartë me 5 për qind të shumës së kontributeve të papaguara. Në asnjë rast shuma nuk mund të jetë më e vogël se 10 000 lekë;
- c) evazioni për pagesën e kontributeve, deklarimi i kontributeve më të ulëta dhe vërtetimi i rremë, kur nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogarit nga ajo që duhet të ishte në fakt;
- ç) refuzimi për dhënien e informacionit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë 10 000 - 50 000 lekë për çdo shkelje.

2. Gjjobat vendosen në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Mospagesat e kontributeve i heqin të drejtën shtetasve për përfitim të shërbimeve shëndetësore të rimbursuara nga Fondi për periudhën e mospagimit të kontributit.

#### Neni 38 **Sanksionet për skemën e sigurimit të detyruar**

1. Dhënësit e shërbimit shëndetësor ndëshkohen për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të kontratës me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Penalitetet parashikohen në kontratat e veçanta dhe mund të variojnë nga gjjoba në lekë deri në përqindje të shumës së kontratës.

2. Shkeljet serioze, të përsëritura të detyrimeve kontraktore nga dhënësit e shërbimeve shëndetësore dhe refuzimi për t'iu nënshtruar kontrollit dhe inspektimit nga Fondi përbëjnë një shkak për prishjen e kontratës dhe heqjen e dhënësit nga Regjistri i Dhënësve të Përzgjedhur të Shërbimeve Shëndetësore. Në të tilla raste, dhënësi i kujdesit shëndetësor mund të riaplikojë për t'u përfshirë në regjistër, pasi ka kaluar një periudhë kohore njëvjeçare.

3. Kërkimi i rimbursimeve për shërbime në bazë të kërkesave të rreme nga të siguarit, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 000 lekë. Vendimi merret nga Fondi, në përputhje me ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

4. Në rast të përsëritjes së kërkesave për rimbursim për shërbime në bazë të kërkesave të rreme, i siguarit ndëshkohet me pezullimin e së drejtës për të përfituar shërbime shëndetësore të rimbursueshme nga 1 deri në 3 muaj.

Neni 39  
**Apelimet kundër vendimeve**

1. Personat e siguruar, kontribuesit dhe dhënësit e kujdesit shëndetësor kanë të drejtën e apelimit të vendimit të gjobës ose të pezullimit të përfitimit, në Drejtorinë e Përgjithshme dhe më pas në gjykatën e shkallës së parë.

2. Këshilli administrativ, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, miraton rregullat dhe procedurën e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ në zyrën qendrore ose vendore të Fondit.

**KREU VIII  
DISPOZITA KALIMTARE**

Neni 40  
**Përfituesit e sigurimit shoqëror**

1. Derisa Fondi të vendosë regjistrimin, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji, të gjithë personat e siguruar me anë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë automatikisht të regjistruar te Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe janë të detyruar për të paguar kontributet për sigurimin shëndetësor të detyrueshëm.

2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të transferojë kontributet e sigurimit të detyruar shëndetësor te Fondi nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të gjithë personat e regjistruar te sigurimet shoqërore.

Neni 41

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 4, 10 pika 6, 11 pika 2, 14 pika 1, 16 pika 3, 19 pika 5, 24 pika 1 shkronja “b”, 27 pikat 5 e 6 dhe 32 pika 4 të këtij ligji.

Neni 42

Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 43

Ky ligj hyn në fuqi 2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6920, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 384, datë 24.2.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9870, DATË 4.2.2008**  
**“PËR STANDARDIZIMIN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për standardet e hartuara e të adoptuara në të gjithë sektorët e ekonomisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për standarde të hartuara, të adoptuara dhe të miratuara nga shoqëri, agjenci dhe/ose organizata të pavarura.”.

Neni 2

Në nenin 8 pika 1 hiqet shprehja “me përjashtim të atyre të fushës së telekomunikacionit”.

Neni 3

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

**Përfaqësimi**

DPS-ja përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC), në Sektorin e Standardizimit të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU-T), në Komitetin European për Standardizimin (CEN), në Komitetin European për Standardizimin në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe në Institutin European të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI).”.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“1. “Forumi Kombëtar i Standardizimit” është organ pranë DPS-së. Anëtar i këtij forumi mund të bëhet çdo person fizik dhe/ose juridik, që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Forumit Kombëtar të Standardizimit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij përcaktohen me rregullore të veçantë të hartuar nga DPS-ja dhe të miratuar nga bordi drejtues i saj.”.



## Neni 5

Në nenin 19, shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:  
“dh) kuotat nga anëtarësimi në Forumin Kombëtar të Standardizimit pranë DPS-së.”.

## Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6921, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

## LIGJ

**Nr.10 385, datë 24.2.2011**

### **PËR NDËRMJETËSIMIN NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

#### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### **Kuptimi i ndërmjetësimit**

1. Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjanes (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

2. Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ndërmjetësit nuk kanë të drejtë të urdhërojnë apo të detyrojnë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

#### Neni 2

#### **Fusha e zbatimit**

1. Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga pikat 2 dhe 3 të këtij neni, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në ato raste kur gjykata, apo organi përkatës shtetëror, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, orientojnë palët drejt ndërmjetësimit, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni.

---

<sup>1</sup> Përafuar me direktivën 2008/52/EC “Mbi disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare”, me nr. CELEX 3200810052.

2. Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare.

3. Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë.

4. Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës apo familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve:

a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;

b) në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes;

c) me karakter pasuror me objekt padie deri në 500 mijë lekë, si dhe për paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit.

5. Në rastin e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur procedimi penal ka nisur, gjykata detyrimisht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

6. Mosmarrëveshjet për të cilat është e detyrueshme zgjidhja në rrugë gjyqësore nuk mund të zgjidhen me ndërmjetësim.

7. Për çështjet, që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, në veprimtarinë e ndërmjetësimit, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë parasysh natyrën ligjore të çështjes.

8. Dispozitat e këtij ligji zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe për procedurën e ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rastet kur vetëm njëra nga palët ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 3

#### **Parimet**

1. Ndërmjetësimi bazohet në parimin e barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, si dhe në respektimin e fleksibilitetit e të transparencës së procedurave dhe të vullnetit të palëve në proces.

2. Ndërmjetësi, në ushtrimin e funksionit të tij, siguron zgjidhjen e çështjes me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri, si dhe në mënyrë profesionale e pa paragjykime ndaj palëve apo çështjes, objekt ndërmjetësimi.

3. Ndërmjetësimi është vullnetar dhe palët në mosmarrëveshje janë të lira:

a) të zgjedhin ndërmjetësimin, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në këtë ligj;

b) të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme;

c) të heqin dorë, në çdo kohë, nga zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim.

4. Ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, ose nëse marrëveshja është arritur, por nuk zbatohet nga palët.

5. Në rastin kur palët arrijnë një marrëveshje për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet tyre, ndërmjetësi nuk ka përgjegjësi për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje.

## KREU II

### LICENCIMI DHE USHTRIMI I VEPRIMTARISË

#### Neni 4

#### **Licencimi**

1. Ndërmjetësi e ushtron veprimtarinë, si person fizik ose juridik, nëpërmjet zyrës a qendrës së tij, pas licencimit dhe regjistrimit të tij në Regjistrin e Ndërmjetësve, sipas këtij ligji.

2. Pranë Ministrisë së Drejtësisë ngrihet Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve, i cili përbëhet nga dy përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe tre përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë. Rregulla më të hollësishme për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve licencon subjektet e interesuara për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit, të cilat regjistrohen, si persona fizikë ose juridikë, në organet kompetente dhe në organet tatimore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Veprimtaria e këtyre subjekteve përfshihet në kategorinë XI.3 të shtojcës bashkëlidhur ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Pranë Ministrisë së Drejtësisë krijohet Regjistri i Ndërmjetësve që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit, si profesion, së bashku me listat e ndërmjetësve përkatës.

5. Regjistri i Ndërmjetësve duhet të përmbajë:

a) identitetin, vendbanimin, numrin e licencës, datën e fillimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit dhe adresën e vendit ku zhvillohet veprimtaria e ndërmjetësimit në rastin e personave fizikë;

b) emërtimin, llojin dhe selinë e shoqërisë, emrin/emrat e administratorëve dhe emrat e ndërmjetësve të punësuar në shoqëri, në rastin e personave juridikë.

6. Forma dhe përmbajtja e Regjistrit të Ndërmjetësve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë përditëson të paktën një herë në vit këtë regjistër dhe siguron publikimin e tij.

#### Neni 5

#### **Kushtet për ndërmjetës**

1. Shtetasi shqiptar ose i huaj, që ushtron profesionin e ndërmjetësimit, duhet të përmbushë njëkohësisht këto kushte:

a) të ketë kryer programe të studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë;

b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç;

c) të mos jetë dënuar për kryerjen me dashje të veprave penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) të ketë përfunduar programin e trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve;

d) të jetë i licencuar dhe i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve.

2. Kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni duhet të përmbushen edhe në rastin kur ligji i veçantë vendos kritere shtesë për ndërmjetësit e procedurave të veçanta të ndërmjetësimit.

#### Neni 6

#### **Heqja e licencës së ndërmjetësimit**

1. Ndërmjetësit i hiqet licenca dhe çregjistrohet nga regjistri në rastet kur:

a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të ndërmjetësimit;

b) humbet apo i kufizohet zotësia për të vepruar;

c) dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje;

ç) kryen shkelje të dispozitave të këtij ligji ose të Kodit të Etikës.

2. Heqja e licencës vendoset nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve, pas paraqitjes së një ankimi nga të tretët dhe sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar.

3. Rregulla më të hollësishme për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi të jetë marrë më parë mendimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

## Neni 7

### **Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve**

1. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve është person juridik, që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti.
2. Organet drejtuese të saj janë mbledhja e përgjithshme e ndërmjetësve dhe kryesia.
3. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka përgjegjësitë e mëposhtme:
  - a) merr masat për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në Republikën e Shqipërisë;
  - b) miraton aktet që rregullojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit, si profesion, si dhe Kodin e Etikës së Ndërmjetësit;
  - c) miraton statutin e saj, ku përcaktohen edhe rregullat e hollësishme për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve;
  - ç) merr masat për themelimin e dhomave vendore të ndërmjetësimit;
  - d) përcakton rregullat për tarifën e shpërblimit, për punën e ndërmjetësit dhe shpenzimet e kryera, si rezultat i veprimtarisë së ndërmjetësimit;
  - dh) harton dhe siguron pjesëmarrjen në program trajnimi të ndërmjetësve;
  - e) përcakton në statut detyrat dhe funksionet e organeve drejtuese të saj;
  - ë) kujdeset për informimin e nevojshëm të publikut për veprimtarinë e ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve.
4. Për realizimin e veprimtarisë së saj dhe në kuadër të cilësisë dhe efektivitetit të procesit të ndërmjetësimit, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin e Provës, Shkollën e Magjistraturës, organizatat jofitimprurëse dhe organe të tjera të sistemit të drejtësisë.

## Neni 8

### **Dhomat e ndërmjetësimit**

1. Çdo dhomë ndërmjetësimi ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat e parashikuara në ligj dhe në statutin e vendimet e tjera, të miratuara nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.
2. Numri minimal i ndërmjetësve, që mund të formojnë një dhomë ndërmjetësimi, caktohet në statutin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve.

## Neni 9

### **Të drejtat e ndërmjetësit dhe trajnimi**

1. Ndërmjetësit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim, të nënshkruar me palët.
2. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve përgatit, të paktën një herë në vit, një program trajnimi të detyrueshëm për të gjithë ndërmjetësit e saporegjistruar pranë Regjistrimit të Ndërmjetësve, si dhe mundëson e kujdeset për trajnimin në vazhdimësi të ndërmjetësve, i cili nuk duhet të jetë më pak se 20 ditë në vit.

## Neni 10

### **Detyrat e ndërmjetësit**

1. Ndërmjetësi e ushtron profesionin e vet në mënyrë të paanshme, me ndershmëri dhe profesionalizëm, respekton rregullat e etikës profesionale dhe përdor të gjitha mjetet e ligjshme për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjeve.
2. Ndërmjetësi nuk ofron këshillim ligjor.

3. Ndërmjetësi ruan konfidencialitetin për të dhënat, për të cilat ka dijeni për shkak të një procedure ndërmjetësimi, në raport me secilën prej palëve apo me persona të tjerë jashtë procedurave të ndërmjetësimit, me përjashtim të rastit kur pala, të dhënat e së cilës bëhen publike ose përpunohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka dhënë miratimin e saj me shkrim.

4. Ndërmjetësi ruan sekretin profesional dhe nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte dhe rrethana, për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit, përveç rasteve kur ka detyrimin me ligj që faktet t'i referojë tek autoritetet proceduese shtetërore.

5. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ndërmjetësi nuk duhet të veprojë si arbitër për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që ka qenë ose është subjekt i procedurave të ndërmjetësimit ose për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje tjetër, që rrjedh nga e njëjta marrëdhënie, e cila i është nënshtruar procedurës së ndërmjetësimit.

6. Me përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton me shkrim, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj gjykatën ose arbitrazhin, me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.

#### Neni 11

### **Konflikti i interesit**

1. Ndërmjetësi siguron që ndërmjet tij dhe palëve në një procedurë ndërmjetësimi nuk ekziston asnjë konflikt interesash. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi heq dorë nga procedurat e ndërmjetësimit.

2. Konsiderohet se ka konflikt interesash kur:

a) ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;

b) ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve;

c) ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë, janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njërën prej palëve;

ç) ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti interesi.

3. Kur një personi i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetës, ai duhet të deklarojë, si dhe të vërë në dijeni palët për çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose të shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në lidhje me rastin që ndërmjetësohet.

4. Ndërmjetësi, duke filluar nga koha e caktimit në këtë detyrë dhe gjatë kohës së procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u deklarojë pa vonesë palëve çdo rrethanë që mund të përbëjë cenim ose dyshim në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

#### KREU III

### **PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT**

#### Neni 12

### **Procedura për ndërmjetësim**

1. Procedura për ndërmjetësim fillon pas datës së paraqitjes së ftesës për ndërmjetësim nga të paktën njëra nga palët në konflikt palës tjetër, sipas këtij ligji, ose nga data e referimit të çështjes nga gjykata për zgjidhjen e saj me ndërmjetësim.

2. Nëse një palë në mosmarrëveshje i kërkon një palë tjetër ndjekjen e procedurave të ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, dhe kjo e fundit nuk i përgjigjet kësaj kërkesë brenda 30 ditëve nga data në të cilën është dërguar ftesa ose brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesë, pala kërkuese mund ta vlerësojë këtë si mospranim të ftesës për ta zgjidhur mosmarrëveshjen me ndërmjetësim. Ftesa për ndërmjetësim, e paraqitur nga një palë në mosmarrëveshje, nuk pengon automatikisht këtë palë që të iniciojë fillimin e një procesi gjyqësor apo arbitrazhi në lidhje me këtë mosmarrëveshje, për shkak të kalimit të afateve të paraqitjes së padisë.

#### Neni 13

##### **Procedura për ndërmjetësim në procesin civil**

1. Gjykata, në përputhje me nenet 4, 25, 158/a, 158/b dhe 297 të Kodit të Procedurës Civile, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 2 të këtij ligji dhe kur palët bien dakord pezullon gjykimin duke u caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes.

2. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit.

#### Neni 14

##### **Procedura për ndërmjetësim në procesin penal**

1. Gjykata, në përputhje me nenet 333 dhe 338 të Kodit të Procedurës Penale, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 3 të këtij ligji, duke iu caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes.

2. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit.

#### Neni 15

##### **Liria e palëve për rregullat dhe mënyrën e ndërmjetësimit**

1. Palët, në përputhje me këtë ligj, janë të lira të vendosin rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit.

2. Palët zgjedhin vullnetarisht një ose më shumë ndërmjetës prej Regjistrisë së Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë.

#### Neni 16

##### **Caktimi i ndërmjetësit**

1. Kur palët bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, ato bashkërisht caktojnë ndërmjetësin nga lista e ndërmjetësve të licencuar.

2. Lista e ndërmjetësve të licencuar duhet të jetë e njohur për publikun dhe e afishuar pranë dhomave të ndërmjetësve, në zyrat e ndërmjetësve që e ushtrojnë ndërmjetësimin, si subjekte juridike ose fizike, si dhe pranë institucioneve të tjera, si gjykata.

#### Neni 17

##### **Zhvillimi i ndërmjetësimit**

1. Përpara fillimit të procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi është i detyruar që të informojë palët për qëllimet dhe parimet e përgjithshme, rolin e ndërmjetësit dhe të palëve në proces, shpenzimet e procesit të ndërmjetësimit dhe efektet e marrëveshjes së ndërmjetësimit.

2. Palët dhe ndërmjetësi nënshkruajnë bashkërisht, me shkrim, marrëveshjen për realizimin e procesit të ndërmjetësimit, ku duhet të përcaktohen:

a) gjenealitetet e palëve të kësaj marrëveshjeje dhe të përfaqësuesve të tyre;

b) përshkrimi i objektit të mosmarrëveshjes;

c) pranimi i parimeve të ndërmjetësimit, sipas këtij ligji dhe të ndërmjetësit të caktuar;

ç) vendi i ndërmjetësimit;

d) shpenzimet e ndërmjetësimit dhe shpërblimi i ndërmjetësit.

3. Në mungesë të një marrëveshjeje për mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit, ndërmjetësit mund ta zhvillojnë ndërmjetësimin në mënyrën më të përshtatshme për palët, mbështetur në rrethanat e çështjes, në çdo kërkesë që mund të paraqesin palët dhe në çdo nevojë për një zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjes.

4. Në çdo rast, në zbatimin e procedurave të ndërmjetësimit, ndërmjetësi duhet të kujdeset për të siguruar trajtimin e njëjtë të palëve, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes.

5. Kur nuk vendoset ndryshe nga palët, ndërmjetësi ka të drejtë që, në çdo fazë të zbatimit të procedurave të ndërmjetësimit, të propozojë një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes.

#### Neni 18 **Komunikimi me palët**

1. Përveçse kur vendoset ndryshe nga palët, ndërmjetësi mund të takojë ose të komunikojë me palët, së bashku ose veçmas me secilën prej tyre.

2. Ndërmjetësi, pasi njihet me rrethanat dhe të dhënat e ofruara nga njëra palë në mosmarrëveshje, mund t'i parashtrijë palës tjetër çështjet thelbësore që rezultojnë nga këto rrethana.

#### Neni 19 **Konfidencialiteti**

1. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, tërësia e të dhënave dhe e rrethanave për procedurat e ndërmjetësimit duhet të mbeten konfidenciale.

2. Pavarësisht nga rregulli i ruajtjes së konfidencialitetit, bëhen publike të dhënat dhe përmbajtja e marrëveshjes së arritur në rastet kur:

a) është e nevojshme për shkaqe të cenimit të interesave themelore të shtetit dhe/apo interesit publik;

b) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e dhunës fizike apo psikologjike ndaj çdo personi, veçanërisht ndaj fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara;

c) është e nevojshme për parandalimin apo ndalimin e keqtrajtimit, të dhunës fizike apo psikike të personave me aftësi të kufizuara;

ç) nëpërmjet bërjes publike të të dhënave dhe/apo marrëveshjes së ndërmjetësimit sigurohet zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 20 **Mospërdorimi i të dhënave**

1. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, një palë që merr pjesë në procedurën e ndërmjetësimit ose një person i tretë, përfshirë dhe ndërmjetësin, nuk mund të kërkojnë ose të përdorin në një proces gjyqësor, arbitrazhi a në ndonjë procedurë tjetër të ngjashme, prova ose dëshmi, pavarësisht nga forma e tyre, si më poshtë:

a) ftesën e një pale për të marrë pjesë në një procedurë ndërmjetësimi ose veprimin me të cilin njëra nga palët ka shprehur vullnetin për të marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit;

b) mendimet e shprehura ose sugjerimet e bëra nga njëra palë gjatë ndërmjetësimit ose nga ndërmjetësi për zgjidhjen e mundshme të mosmarrëveshjes;

c) deklaratat ose pohimet e bëra nga njëra palë gjatë zhvillimit të procedurës së ndërmjetësimit;

ç) propozimet e bëra nga ndërmjetësi;

d) faktin që njëra nga palët në procedurën e ndërmjetësimit ka shprehur vullnetin për të pranuar propozimin e bërë nga ndërmjetësi ose zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

dh) një dokument të përgatitur vetëm për qëllim të procedurës së ndërmjetësimit.

2. Rregullat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni zbatohen nga gjykata, arbitrazhi dhe në procedura të tjera të ngjashme, pavarësisht nëse këto organe e shqyrtojnë një mosmarrëveshje që ka qenë ose është në procedurën e ndërmjetësimit.

#### Neni 21 **Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit**

Procedura e ndërmjetësimit përfundon:

a) ditën e nënshkrimit të marrëveshjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes;

- b) ditën e nënshkrimit të deklaratës me shkrim të ndërmjetësit, pas këshillimit me palët që ndërmjetësohen, sepse përpjekjet për ndërmjetësim të mëtejshëm nuk janë të justifikuar;
- c) ditën e nënshkrimit të deklaratës me shkrim të palëve ndërmjetëse, me anë të së cilës i drejtohen ndërmjetësit, ku i njoftojnë se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar;
- ç) ditën e nënshkrimit të deklaratës me shkrim të njëjës palë, drejtuar palës tjetër, ndërmjetësit, ku njoftohen se procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar;
- d) me vdekjen e ndonjëres nga palët në proces;
- dh) me likuidimin e personit juridik, palë në proces.

## Neni 22

### **Aktmarrëveshja**

1. Kur palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me ndërmjetësit, nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe në zbatim të kushteve, rasteve dhe të procedurave të parashikuara në këtë ligj. Kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit.

2. Në aktmarrëveshje përcaktohen:

- a) palët;
- b) përshkrimi i mosmarrëveshjes;
- c) detyrimet e kushtet që palët i vënë njëra-tjetrës dhe mënyra e afati i përmbushjes së tyre;
- ç) nënshkrimi i palëve dhe i ndërmjetësit.

Afati për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje vendoset nga palët në mirëkuptim me njëra-tjetrën. Aktmarrëveshja duhet të përmbajë detyrime të qarta dhe saktësisht të përcaktuara.

3. Aktmarrëveshja lidhet me shkrim, përveç rasteve kur ndërmjetësi dhe palët vlerësojnë se ajo mund të lidhet me gojë, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, si dhe kur ligji nuk e ndalon një gjë të tillë.

4. Aktmarrëveshja hartohet në tri kopje, një për secilën palë dhe një kopje që depozitohet te subjekti ndërmjetës, i cili është i detyruar të administrojë çdo aktmarrëveshje dhe dokumentacion lidhur me to, sipas rregullave të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

## Neni 23

### **Zbatimi i marrëveshjes së ndërmjetësimit**

1. Kur çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, ose në afatin e përcaktuar prej tyre, i njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse.

2. Në rastin kur është zgjidhur çështja me anë të ndërmjetësimit, organet gjyqësore vendosin, sipas rastit, miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes civile ose pushimin e çështjes penale apo mosfillimin e procedimit penal, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri.

3. Nëse aktmarrëveshja respekton kushtet e përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, përbën titull ekzekutiv dhe, në këtë rast, ngarkohet shërbimi përmbartimor për ekzekutimin e tij.

4. Kur bëhet kundërshtim, gjykata merr parasysh mënyrën e zgjidhjes me ndërmjetësim, por, gjithashtu, nuk ka pengesë ligjore për zgjidhje tjetër, në përputhje me ligjin.

## Neni 24

### **Pavlefshmëria e ndërmjetësimit**

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, në kuptim të këtij ligji, është e pavlefshme kur:

- a) realizohet nga persona që nuk janë ndërmjetës të licencuar dhe të regjistruar sipas këtij ligji;



- b) mosmarrëveshja, sipas ligjit, duhet zgjidhur vetëm në rrugë gjyqësore;
- c) përmban detyrime të vlerësueshme në të holla dhe nuk formulohet me shkrim;
- ç) përmban detyrime për subjekte që nuk kanë marrë pjesë në ndërmjetësim;
- d) ka simulim dhe, për konfliktin real, ka shkaqe pavlefshmërie.

2. Gjykata, përveç rasteve të parashikuara në Kodin Civil për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, mund ta konstatojë marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim të pavlefshme edhe kur arrin në përfundimin se ajo nuk respekton rendin publik në Republikën e Shqipërisë.

3. Pavlefshmëria e marrëveshjes së ndërmjetësimit, sipas këtij ligji, nuk i pengon palët në konflikt të realizojnë marrëveshjen e arritur, duke ushtruar të drejtat që gëzojnë me ligje të tjera.

## KREU IV DISPOZITAT E FUNDIT

### Neni 25 **Aktet nënligjore**

1. Këshilli i Ministrave, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton:

a) vendimin e parashikuar në nenin 4 pika 2 të këtij ligji, bazuar në parimin e ligjshmërisë dhe transparencës;

b) vendimin e parashikuar në nenin 6 pika 3 të këtij ligji, bazuar në parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës.

2. Ministri i Drejtësisë, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton urdhrin e parashikuar në nenin 4 pika 6 të këtij ligji, bazuar në parimin e ligjshmërisë.

3. Dhoma miraton aktet, që rregullojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit si profesion, si dhe Kodin e Etikës së Ndërmjetësit, brenda tre muajve nga krijimi i saj.

### Neni 26 **Dispozitë kalimtare**

1. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, subjektet që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të ndërmjetësit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9090, datë 26.6.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, paraqesin kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë për regjistrimin e tyre në Regjistrin e Ndërmjetësve.

2. Ministria e Drejtësisë, kur konstaton se subjektet që kanë paraqitur kërkesë, sipas pikës 1 të këtij neni, janë regjistruar në gjykatë si persona fizikë ose juridikë dhe në organet tatimore, sipas ligjit nr.9090, datë 26.3.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i regjistron ata në Regjistrin e Ndërmjetësve.

### Neni 27 **Shfuqizime**

Ligji nr.9090, datë 26.6.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, shfuqizohet.

### Neni 28 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6922, datë 8.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 386, datë 3.3.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SË NATO-S PËR MIRËMBAJTJEN DHE FURNIZIMIN (NAMSA), PËR DEMONTIMIN E MUNICIONEVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së NATO-s për Mirëmbajtjen dhe Furnizimin (NAMSA), për demontimin e municioneve”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6928, datë 18.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

NATO-ja e paklasifikuar  
SA NO ALB-001

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**AGJENCISË SË NATO-S PËR FURNIZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN (NAMSA), MBI**  
**DEMONTIMIN E MUNICIONEVE**

**1. Hyrje**

1.1. Duke marrë në konsideratë misionin që i është besuar NAMSA-s, sipas neneve 5, 6 dhe 37 të Kartës së NAMSO-s dhe direktivave të zbatueshme të NAMSO-s dhe rregulloreve të NAMSA-s, kjo Marrëveshje përcakton modalitetet sipas të cilave NAMSA duhet të ofrojë shërbime dhe/ose prokurorë mallra në emër të NATO-s.

1.2 Duke vlerësuar se kjo Marrëveshje lidhet për një projekt mbi demontimin e stoqeve të mbetura të municioneve të tepërta në Shqipëri, siç përshkruhet në përmbledhjen e projektit në shtojcën A.

1.3 Duke theksuar rëndësinë e ofrimit të pajisjeve të sigurta dhe ekonomike, si dhe përdorimin e teknologjisë së sigurt dhe respektimin e kërkesave kombëtare për mbrojtjen e duhur mjedisore.

1.4 Duke vlerësuar nevojën për një ekuilibër të duhur ndërmjet investimeve të kapitalit dhe shpenzimeve administrative.

1.5 Duke vlerësuar se kjo Marrëveshje është lidhur brenda anëtarësimit të Shqipërisë në NAMSO me direktivat përkatëse të NAMSO-s dhe rregulloret e NAMSO-s.

1.6 Duke marrë në konsideratë se kjo Marrëveshje nuk është në kontratë tregtare, por zbatimi i politikës së NAMSO-s siç përcaktohet në direktivën funksionale të NAMSO-s 252, është një marrëveshje brenda NATO-s dhe jo kontratë ligjrisht detyruese e zbatueshme para një gjykate.

## 2. Caktimi i palëve

Kjo Marrëveshje lidhet ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, në vijim e referuar si MM, e përfaqësuar nga:

Zëvendësministri i Mbrojtjes

Z. Ekrem Spahia dhe

Agjencisë së NATO-s për furnizimin dhe mirëmbajtjen, në vijim e referuar si NAMSA, e përfaqësuar nga:

Drejtori i Prokurimit

Z. Patrick Fesquet

## 3. Qëllimi i Marrëveshjes

3.1 Kjo Marrëveshje përcakton më tej fushën e veprimit të projektit të ekzekutuar të NAMSA-s për të lehtësuar përpjekjet e MM-së shqiptare për demontimin e stokut të municioneve të tepërta.

3.2 Pavarësisht nga përpjekjet e konsiderueshme të bëra gjatë dekadës së shkuar për të zvogëluar rreziqet e shoqëruara me stoqet e tepërta jashtë afatit të përdorimit të municioneve, që prej fundit të vitit 2009 u llogarit një mbetje prej 76 000 tonë. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes janë tërësisht të angazhuar për zgjidhjen e çështjes së municioneve të tepërta jo më vonë se fundi i vitit 2013 dhe për këtë qëllim kanë zhvilluar një plan kombëtar veprimi (PKV). Për të ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi, njihet nevoja e ndihmës ndërkombëtare.

3.3 Me kërkesën e delegacionit shqiptar në NATO dhe Departamentit Amerikan të Zyrës Shtetërore për Heqjen e Pakësimin e Armëve (WRA), NAMSA bëri një propozim për të shkatërruar 76 000 tonë municione të tepërta gjatë 4 viteve të tri vendeve industriale demontimi dhe disa vende për djegien dhe demontimin e hapur (OBOD). Një përmbledhje përfshihet në shtojcën A. Propozimi hartohet për të qenë koherent me NAP, në mënyrë që niveli i ndihmës ndërkombëtare të mund të ndryshohet për arritjen e prioriteteve të ndryshueshme gjatë projektit të parashikuar 4-vjeçar. Ndryshimet në propozim duhet të bëhen në marrëveshjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe si vend udhëheqës në bashkërendim me kontribuesit.

3.4 Ky propozim, me titull “Propozimi për shkatërrimin e stoqeve të municioneve të tepërta në Shqipëri” i dhjetorit 2009 u paraqit më 29 mars 2010 në Komitetin Politik të NATO-s (AC-119-DS (2010) 0023). Përfundimisht, Komiteti Politik miratoi përdorimin e një mekanizmi të fondit të besimit për një anëtar të NATO-s. Ky parashikon një mekanizëm për ngritjen e fondeve që monitorohet në mënyrë të pavarur nga Bordi Ndërkombëtar i Kontrollorëve Financiarë për NATO-n (IBAN).

3.5 MM kërkon që NAMSA të veprojë si agjent ekzekutiv për këtë projekt fondi besimi, siç përcaktohet në propozim dhe në politikën e fondit të besimit të NATO-s.

## 4. Data e hyrjes në fuqi, kohëzgjatja dhe ndryshimi

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore të nevojshme dhe do të përfundojë kur të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të jenë plotësuar me anë të shkëmbimit të thjeshtë të letrave. Zbatimi i projektit do të fillojë pasi kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

4.2 Kohëzgjatja totale e projektit llogaritet të jetë 4 (katër) vjet. Kohëzgjatja e tij do të shtrihet automatikisht në periudha të njëpasnjëshme prej 1 (një) viti derisa projekti të përfundojë zyrtarisht me anë të shkëmbimit të korrespondencës ose të shkurtohet pas mungesës së disponueshmërisë së fondeve.

4.3 Në çdo kohë, kjo Marrëveshje mund të përfundojë, ndryshohet ose amendohet me shkrim me anë të pëlqimit të ndërsjellë. Secili prej këtyre dokumenteve do të quhet “Amendim” dhe do të numërohet në mënyrë të njëpasnjëshme, duke filluar me numrin një (1).

4.4 Çdo palë duhet t’i japë palës tjetër një njoftim paraprak tre (3)-muor me shkrim dhe me postë rekomande në lidhje me vendimin e saj për t’i dhënë fund Marrëveshjes.

4.5 Në rast të përfundimit të Marrëveshjes, të dhënat e porosive para datës së përfundimit do të trajtohen sipas të njëjtëve terma dhe kushte, që ishin të vlefshëm në kohën kur këto porosi u vendosën në NAMSA-n.

#### 5. Shuma e marrëveshjes

5.1 Shuma e llogaritur e propozimit fillestar të projektit është deri maksimumi 35.8 M euro. Kostot e llogaritura operacionale dhe administrative, që përfshijnë investimet e kapitalit, do të përditësohen para zbatimit të projektit.

5.2 Të gjitha kostot e shkaktuara sipas këtij projekti do të mbulohen nga kontribuesit e projektit të fondit të besimit. Shqipëria do të sigurojë një shumë të llogaritur deri në 8.5 M euro nëpërmjet kontributeve në natyrë, siç përcaktohet në propozimin që do të përditësohet para zbatimit të projektit.<sup>2</sup>

#### 6. Përgjegjësitë e NAMSA-s

##### 6.1 Zbatimi i projektit

6.1.1 NAMSA është përgjegjëse për zbatimin e duhur të projektit, siç përshkruhet në propozim dhe në përputhje me direktivën funksionale të NAMSO-s (FD) 410. Ndryshime të mundshme në projekt ose në zbatim do të bëhen vetëm me shkrim me pëlqimin e palëve.

6.1.2 Zbatimi i projektit do të fillojë kur kontribuesit të kenë dhënë konfirmim me shkrim për zotimet financiare që arrijnë shumën totale prej 1.2 M euro, duke marrë parasysh grafikun e kontributeve për secilin kontribues dhe detyrimet e pagesave ndaj kontraktuesve të NAMSA-s.

6.1.3 NAMSA do të fillojë zbatimin e elementeve të ndryshme të projektit në përputhje me prioritetet e rena dakord të identifikuar nga MM dhe kontribuesit, në konsultim me NAMSA-n.

6.1.4 NAMSA do të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të garantuar zbatimin e duhur të projektit, në përputhje me fondet e vëna në dispozicion.

##### 6.2 Administrimi i fondeve

6.2.1. Fondet administrohen nga Drejtoria e Financave e NAMSA-s.

6.2.2 Fondet e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje do të transferohen te NAMSA nga kontribuesit brenda 30 ditësh nga kërkesa për fonde, e bërë nga NAMSA. Këto fonde vendosen në një llogari të NAMSA-s të identifikuar për këtë projekt.

6.2.3 Fondet që mbeten pas përfundimit të projektit do t'i kthehen kontribuesve me përfundimin e projektit.

6.2.4 Sipas direktivës funksionale të NAMSO-s nr.410, NAMSA do të jetë përgjegjëse, brenda kufijve të përcaktuar në kartën e saj dhe në përputhje me qëllimet e përcaktuara në të, për administrimin e duhur të fondeve.

6.2.5 NAMSA administron dhe justifikon fondet në përputhje me rregulloret financiare të NAMSA-s, rregullat dhe procedurat (FD 410) dhe mban regjistra dhe llogari të veçanta për projektin. Këta regjistra i vihen në dispozicion MM-së sipas kërkesës. MM gëzon të drejtën për të kërkuar një kontroll financiar, nëse ky veprim do të konsiderohej i nevojshëm. Kontrolli financiar duhet të kryhet nga Bordi Ndërkombëtar i Kontrollorëve Financiarë për NATO-n (IBAN).

6.2.6 Nëse, për ndonjë arsye të ndryshme nga ajo e përmendur më sipër, veçanërisht në lidhje me fondet e marra përsipër nga kontribuesit dhe jo përmes ndonjë mospërmbyshjeje të detyrimeve nga NAMSA, siç përmendet në nenin 7.4, mund të plotësohet vetëm një pjesë e punimit të kërkuar në këtë Marrëveshje, vetëm ato fonde të kërkuara për atë pjesë të punimit që ka përfunduar mund të shpenzohen nga NAMSA.

##### 6.3 Raportimi

6.3.1 NAMSA i jep MM-së brenda tridhjetë (30) ditëve nga përfundimi i çdo periudhe tremujore (tre muaj) raporte ecurie mbi fondin e besimit.

---

<sup>2</sup> Shënim shpjegues: Mekanizmi i fondit të besimit nuk lejon NAMSA-n të hyjë në angazhime përtej fondeve të autorizuara dhe të disponueshme. Më tej, NAMSA mund të hyjë vetëm në ndonjë angazhim me miratimin zyrtar të MM-së si kombi udhëheqës në emër të kontribuesve). Kjo arrihet normalisht nëpërmjet mbështetjes së propozimit të projektit ose shtesës së propozimit të projektit. Ndryshime të vogla mund të bihen dakord nga procedurat e propozimit të ndryshimeve.

6.3.2 NAMSA paraqet një raport përfundimtar vlerësimi, që përfshin një deklaratë financiare, e cila tregon fondet e marra dhe të shpenzuara për projektin, jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas përfundimit të projektit.

#### 6.4 Pronësia e projektit

6.4.1 Si masë për ndërtimin e kapaciteteve dhe nëse nuk deklarohet ndryshe, pajisjet dhe furnizimet e blera ose të dorëzuara nga NAMSA nga fondet e fondit të besimit do të mbeten në pronësi të MM-së.

6.4.2 Pajisjet dhe furnizimet e blera nga NAMSA nga fondet e kontribuesve për përdorim nga ekipi i manaxhimit në vend konsiderohen si pronë e projektit dhe i nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta me MM-në në lidhje me metodat e menaxhimit dhe shitjen e pajisjeve të projektit në vend. Rrjedhimisht, para mbylljes së projektit, MM do të orientojë NAMSA-n për veprimin e shitjes për të marrë pronësinë e ardhshme në vend. Kjo mund të përfshijë, por nuk mund të kufizohet në dhurim për institucionet lokale, transferim në një projekt tjetër ose shitje.

6.4.3 NAMSA fillon veprimin e anulimit ose nxjerrjes nga përdorimi për ato objekte që nuk kërkohen më në përputhje me manualin FD 410. Manuali FD 410 zbatohet për inventarin dhe regjistrimin e pasurisë. Çdo humbje pasurie do të fshihet në regjistrat e Agjencisë dhe MM do të informohet në lidhje me këtë.

6.4.4 Çdo dhurim i pronës që urdhërohet me shkrim nga MM trajtohet si shitje në vlerën zero në llogaritë e fondit të besimit.

6.4.5 Pas përfundimit të projektit, të ardhurat nga shitjet e ndonjë pasurie të mbetur do t'i kthehen MM-së.

6.5 NAMSA do të ndihmojë në rishikimet e projektit, siç kërkohet nga MM. Këto rishikime do të përfshijnë verifikimin e duhur dhe garantimin e cilësisë që duhet të kryhen nga një autoritet i kualifikuar nëse kërkohet nga MM.

#### 7. Përgjegjësitë e MM-së

7.1 MM merr ato masa që janë brenda zgjedhjes së vetme të MM-së dhe që duhet të merren, me qëllim lejitim të zbatimit dhe ekzekutimit të duhur të kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Përveç përgjegjësisë së saj të zakonshme si shtet anëtar i NAMSO-s, Shqipëria nuk ka asnjë përgjegjësi tjetër nga ato të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

7.3 MM në emër të kontribuesve rezervon të drejtën, pas konsultimit paraprak me NAMSA-n, të zvogëlojë ose të përfundojë më herët kontributin ndaj projektit. Nëse financimi ulet ose përfundon, kostot e shkaktuara nga NAMSA për kryerjen e punimit dhe kostot përkatëse të përfundimit do të paguhen nga MM-ja.

7.4 MM, në emër të kontribuesve, mund të kërkojë shlyerjen e të gjitha ose një pjese të fondeve të transferuara nëse angazhimet financiare sipas kësaj Marrëveshjeje nuk janë përmbushur; ose nëse nga raportet e përmendura më parë ose nga ndonjë burim tjetër del se fondet nuk përdoren ose nuk janë përdorur për zbatimin e projektit të rënë dakord; ose nëse duket të jetë siguruar financimi alternativ (tërësisht ose pjesërisht), duke shkaktuar kështu financimin e dyfishtë (kjo përfshin kontribute të tjera).

7.5 MM ka rënë dakord të sigurojë kontribut në natyrë për projektin, siç përcaktohet hollësisht në paragrafin 5.2. MM është plotësisht përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe aktiviteteve në natyrë, siç përshkruhet në propozimin e projektit.

7.6 Municionet që duhet të përpunohen dhe mbetjet e ndryshme dhe materialet që rrjedhin nga procesi i demontimit mbeten në çdo kohë pronë e MM-së.

#### 8. Pikat e kontaktit

Të gjitha komunikimet dhe masat vendosen ndërmjet palëve, si më poshtë:

##### 8.1 Për NAMSA-n

Programme Management

General Services Programme Manager

Dr.Bülent Tüdes

+3523063 6311

[btudes@namsa.nato.int](mailto:btudes@namsa.nato.int)

Technical Project Management  
Technical Officer (Ammunition)  
Mr. David Towndrow  
+352 3063 7234

[dtowndrow@namsa.nato.int](mailto:dtowndrow@namsa.nato.int)

8.2 Për MM-në

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve dhe Modernizimit  
Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë  
Zoti Helidon Bushati  
Tel: + +355 4 226 601/ext 1014  
Mob: + +355 68 40 69 800  
Fax: + +355 4 2 225 227  
Email: hbushati@mod.gov.al

Shefi i Sektorit të Materialeve të Tepërta  
Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë  
Major Shkëlqim Sina  
Te: 00355 4 226601/2/3 ext.2086  
Cel: 00355 68 92 544  
E-mail: sinash@mod.gov.al

#### 9. Kushtet e çmimit

Çmimi (kostot operacionale dhe administrative që përfshijnë investimin e kapitalit) vendosen në përputhje me direktivat funksionale aktualë të NAMSO-s nr.410 dhe nr.421 (politikat e caktimit të çmimeve)<sup>3</sup>.

#### 10. Kushtet financiare

##### 10.1 Shpenzimet administrative të NAMSA-s

Shpenzimet administrative të NAMSA-s për të gjitha aktivitetet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të llogariten mbi bazën e sipërmarrjes së menaxhimit të kërkuar nga personeli i punësuar në programin e përgjithshëm të shërbimeve. Kjo do të shprehet në punën e një personi në vit dhe do të konvertohet në një kosto tërësisht të detyrueshme si pjesë e buxhetit të projektit.

##### 10.2 Kostot operacionale të NAMSA-s

Drejtoria financiare e NAMSA-s do të veprojë si ruajtëse thesari e fondit të besimit. NAMSA do të kërkojë periodikisht fondet e nevojshme për të mundësuar pagesën e faturave të kontraktuesve, blerjet e pajisjeve dhe pagesën e personelit drejtpërdrejt nga NAMSA.

#### 11. Taksat dhe tatimet doganore

Furnizimet dhe shërbimet e siguruara nga NAMSA zakonisht janë pa TVSH. Nëse kërkohet pagesa e ndonjë takse dhe/ose tatimi, ato do të përballohen nga MM.

#### 12. Garantimi i cilësisë

12.1 Garantimi i cilësisë dhe pranimi i shërbimeve do të kryhen në përputhje me direktivën funksionale aktuale të NAMSO-s 254 mbi garantimin e cilësisë dhe udhëzimet e saj zbatuese në përmbajtje të rregullores së NAMSA-s mbi garantimin e cilësisë (nr.254-01) dhe Manualit të cilësisë së NAMSA-s (NI 254-02).

12.2 Pranimi i shërbimeve të siguruara nga kontraktuesit civilë do të bëhet nga përfaqësuesi i deleguar kombëtar i garantimit të cilësisë (në përputhje me STANAG 4107) në vendin e kontraktuesit të caktuar dhe në bashkërendim me NAMSA-n.

---

<sup>3</sup> Shënim shpjegues: Propozimi i projektit përcakton kostot totale të llogaritura dhe metodat e prokurimit. Përgjithësisht, pajisjet kryesore të kapitalit dhe shërbimet e specialistëve do të prokurohen sipas konkurrencës ndërkombëtare dhe zërave dytësorë të kapitalit që rrjedhin nga Shqipëria. Shumica e kontratave të demontimit do të negociohen drejtpërdrejt me shërbimet ekzistuese industriale. Disa kontrata për demontimin pas konkurrencës mund t'u lihen kompanive ndërkombëtare.

### 13. Garancia

13.1 Garancia nga kontraktuesi i NAMSA-s duhet të jepet në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme ose siç bihet dakord në deklaratën e punimeve dhe do të përfitojë pronari përfundimtar i mallrave dhe/ose shërbimeve të dorëzuara.

13.2 NAMSA nuk është në gjendje të ofrojë garanci mbi mallrat ose defektet e mallrave të dorëzuara nga kontraktuesit e saj.

13.3 MM duhet të identifikojë dhe raportojë menjëherë çdo defekt të dukshëm në mallrat e dorëzuara ose shërbimet e dhëna, në mënyrë që t'i mundësojë NAMSA-s të raportojë dhe refuzojë pranimin e mallrave ose shërbimeve të dorëzuara.

13.4 MM duhet të raportojë NAMSA-s të gjitha rastet e garancisë me justifikim të plotë, për të lejuar NAMSA-n të fillojë dhe ndjekë një padi kundër kontraktuesit, në interes të MM-së.

### 14. Mospërputhjet

14.1 Mospërputhjet në lidhje me furnizimet/shërbimet do t'i raportohen NAMSA-s në një formular raporti mospërputhjesh (DR), sipas udhëzimeve të përcaktuara në manualin logjistik të NAMSA-s nr.200-00.

14.2 Statusi i të gjitha mospërputhjeve të dukshme dhe garancive do t'i dërgohet MM-së, sipas kërkesës.

### 15. Mosmarrëveshjet

15.1 Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, keqkuptimi ose vështirësi tjetër që lind nga ekzekutimi i një kërkesë zyrtare, kërkesë për shërbime ose hetime, MM dhe NAMSA do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të arritur një zgjidhje miqësore.

15.2 Në pamundësi të kësaj, kjo vështirësi do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e nenit XXIV të Marrëveshjes mbi statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior, përfaqësuesve Kombëtarë dhe Personelit Ndërkombëtar, të nënshkruar më 20 shtator 1951 (Marrëveshja e Otavës).

### 16. Përgjegjësia

Sipas nenit 15 të direktivës funksionale të NAMSO-s nr.410

16.1 MM bie dakord të marrë përsipër të gjitha rreziqet në kryerjen e shërbimeve të siguruara nga NAMSA dhe të përballojë të gjitha kostot financiare që mund të lindin nga përgjegjësitë ligjore të shkaktuara nga NATO/NAMSO në ekzekutimin e shërbimeve të kërkuara nga NAMSA. Kjo përfshin çdo përgjegjësi ligjore të shkaktuar nga veprimet dhe/ose mosveprimet e NAMSA-s, duke përfshirë ato që lindin nga marrëveshje të ndonjë lloji të lidhur nga NAMSA ose kontratat e ndonjë lloji të vendosura nga NAMSA, për të prokuruar mallrat dhe/ose shërbimet e dëshiruara në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

16.2 Nëse NAMSA i shkakton MM-së përgjegjësi ose pretendime në lidhje me ndonjë shërbim, marrëveshje ose veprim të kryer nga NAMSA në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, kostot dhe shpenzimet përkatëse do të përballohen nga MM, por në rast dëmi, përgjegjësi për humbjet e shkaktuara nga një palë e tretë ose nga një veprim keqdashës ose neglizhencë flagrante nga një anëtar i personelit të NAMSA-s, NAMSA do të kujdeset që personat përgjegjës të shlyejnë çdo shumë të kërkueshme në përputhje me ligjet dhe rregulloret ekzistuese. Në asnjë rrethanë, sa më sipër nuk do t'i shkaktojë NAMSO-s asnjë përgjegjësi.

### 17. Përmbajtja dhe dispozita të përgjithshme

Kjo Marrëveshje përbëhet nga klauzola të veçanta që përfshijnë 17 klauzola, duke përfshirë këtë klauzolë, dispozitat e përgjithshme të NAMSA-s për shitjet (direktiva funksionale NAMSO nr.252) dhe shtojcën A (përmbledhje e projektit).

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
Zëvendësministri i Mbrojtjes  
Ekrem Spahia**

**PËR AGJENCINË E NATO-S TË  
FURNIZIMIT DHE MIRËMBAJTJES  
Drejtori i Prokurimit  
Patrick Fesquet**

## SHTOJCA A PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

1. NAMSA-s iu kërkua të përgatiste këtë propozim projekti bashkë me Departamentin Amerikan të Zyrës Shtetërore të Heqjes dhe Pakësimit të Armëve (WRA) dhe misionin shqiptar në NATO. Propozimi është për një projekt 4-vjeçar me buxhet prej 35.8 milionë euro për asgjësimin e 85 000 tonë municionesh të tepërta. Projekti duhet të menaxhohet nga Agjencia e NATO-s për Furnizimin dhe Mirëmbajtjen (NAMSA) ose sipas marrëveshjeve dypalëshe me SHBA-në dhe Shqipërinë, ose si projekt i fondit të besimit të NATO-s.

2. Gjatë dekadës së shkuar janë shkatërruar sasi të konsiderueshme municioni, shpesh me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë dhe organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë NATO-n dhe vendet e saj partnere dhe anëtare. Stoku i mbetur i tepërt llogaritet në 85 000 tonë. Shkatërrimi i këtij stoku brenda një grafiku kohor të arsyeshëm do të kërkojë mbështetje të mëtejshme ndërkombëtare.

3. Fokusi kryesor në këtë propozim i është dhënë kapaciteteve të përmirësuara në programet ekzistuese të Shqipërisë mbi demontimin brenda kuadrit të planit kombëtar të veprimit për demontimin e Qeverisë Shqiptare. Propozimi rekomandon zhvillim të mëtejshëm të shërbimit ULP Mjekës si një vend afatgjatë demontimi, plus zhvillimin e kufizuar të KM Poliçan dhe UM Gramsh si shërbime të përkohshme demontimi për periudhën e programit të propozuar 4-vjeçar.

4. Operacionet e përshtatura më mirë për përpunim nga FASH për asgjësim me djegie dhe demontim të hapur (OBOD) do të mbeten përgjegjësi e FASH-it dhe mund të përfshijnë rreth 23 000 tonë municione. Ky propozim përfshin rishikime periodike sigurie të operacioneve të OBOD-it dhe zhvillimin e shërbimeve të kërkuara për një vend të caktuar të OBOD-it në Bizet, Shqipëri.

5. Ky propozim parashikon që kontributet e konsiderueshme ndaj projektit do të bëhen nga Shqipëria. Këto kontribute duhet të përfshijnë sigurimin e transportimit të municioneve nga vendet e ruajtjes në vendet e planifikuara të demontimit, duke përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin. Më tej parashikohet që Shqipëria të sigurojë burimet për të mbështetur fushatën OBOD të AAF-së. Vlera e këtyre kontributeve varion nga 3.0-8.5 milionë euro, në varësi të sasisë përfundimtare të municioneve të identifikuar për OBOD-in.

6. NAMSA do të jetë agjenci ekzekutive për këtë projekt dhe do të kryejë ose bashkërendojë verifikimin e pavarur të të gjitha aktiviteteve dhe shpenzimeve. NAMSA do të japë kontrata për të mbështetur prokurimin e pajisjeve të kapitalit të specialistëve nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar. NAMSA do të negociojë kontrata drejtpërdrejt me ULP Mjekës, KM Poliçan dhe UM Gramsh për proceset e shkatërrimit të parashikuar në secilin prej këtyre shërbimeve.

7. Projekti mund të fillojë pas lidhjes së marrëveshjeve të nevojshme, me kusht që të vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme.



**LIGJ**  
**Nr.10 387, datë 3.3.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË EUROPËS  
PËR ZYRËN E KËSHILLIT TË EUROPËS NË TIRANË DHE STATUSIN E SAJ LIGJOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Europës për zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë dhe statusin e saj ligjor.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6929, datë 18.3.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**KËSHILLIT TË EUROPËS LIDHUR ME ZYRËN E KËSHILLIT TË EUROPËS NË TIRANË**  
**DHE STATUSIN E SAJ LIGJOR**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Europës (më poshtë të quajtur “Palë”);

*nisur nga rezoluta CM/Res (2010) mbi statusin e zyrave të Këshillit të Europës, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 7 korrik 2010;*

*në bazë të dispozitave të Konventës së Vjenës të vitit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike dhe marrëveshjes së përgjithshme mbi privilegjet dhe imunitetet (më poshtë të quajtur MPPI) e Këshillit të Europës të nënshkruar në Paris më 2 shtator 1949, ku Republika e Shqipërisë është palë, kanë rënë dakord si më poshtë:*

1. Ndërmjet palëve vendoset një formë e re institucionale bashkëpunimi nëpërmjet hapjes në Tiranë të Zyrës së Këshillit të Europës (më poshtë e quajtur “Zyrë”. Kjo zyrë zëvendëson zyrën ekzistuese në Tiranë, duke trashëguar pasurinë dhe dokumentacionin e saj.

Memorandumi i tanishëm i mirëkuptimit zëvendëson “Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Europës, lidhur me statusin e Zyrës së Informacionit të Këshillit të Europës në Republikën e Shqipërisë”, të nënshkruar më 26 qershor 2003.

2. Objektivat kryesorë të zyrës do të jenë si më poshtë:

a) Përfaqësimi i Sekretarit të Përgjithshëm pranë autoriteteve kombëtare të vendit pritës;

b) Nxitja dhe mbështetja e politikave dhe veprimtarive të autoriteteve kombëtare dhe e organeve të Këshillit të Europës lidhur me anëtarësinë në Këshillin e Europës;

c) këshillimi, mbështetja dhe koordinimi i përgjithshëm në vend me autoritetet kombëtare për planifikimin, negocimin dhe zbatimin në kohë të veprimtarive që janë objekt i bashkëpunimit me Këshillin e Europës, duke përfshirë programet e përbashkëta me BE-në dhe donatorë të tjerë;

d) lehtësimi i identifikimit të nevojave për krijimin e kapaciteteve, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare;

e) zhvillimi i fushatave për grumbullim fondesh për projekte të veçanta;

f) koordinimi i veprimtarive në vend me organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare (BE, OSBE, OKB), si dhe me partnerë të tjerë vendas dhe ndërkombëtarë që janë aktivë në vend;

g) ndjekja e një politike proaktive mediatike, me synim rritjen e tejpashmërisë së organizatës, vlerave dhe veprimtarive të saj për publikun e përgjithshëm.

3. Personeli i kësaj zyre do të plotësohet me zyrtarë të Këshillit të Europës (më poshtë të quajtur “Nëpunësit e zyrës”), të cilët përfshijnë kategoritë e poshtëshënuara: pjesëtarë të stafit të Këshillit të Europës, të punësuar sipas Rregullores së Stafit dhe Rregullave të Këshillit të Europës, duke përfshirë stafin e rekrutuar me vendas dhe me zyrtarë të emëruar në Këshillin e Europës në pajtim me rregullat përkatëse.

4. Këshilli i Europës do të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë mbi emrin, funksionet dhe kategorinë e nëpunësve të zyrës në Tiranë.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të emërojë shefin e zyrës dhe do të njoftojë me shkrim Ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë mbi vendimin e tij/saj.

6. Si institucion i Këshillit të Europës, zyra dhe nëpunësit e saj do të përfitojnë nga dispozitat e MPPI-së.

7. Si institucion i Këshillit të Europës, zyra do të ketë personalitet ligjor dhe të drejtën të mbyllë kontrata, të disponojë dhe të heqë nga përdorimi prona të luajtshme, të fillojë procedim ligjor, të hapë dhe të zotërojë llogari bankare në monedhën vendase dhe të huaj.

8. Zyra, pronat dhe pasuritë e saj do të gëzojnë imunitet nga çdo formë e një procesi ligjor, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur Këshilli i Ministrave autorizon shprehimisht dorëzimin e këtij imuniteti. Megjithatë, do të ketë mirëkuptim për faktin që heqja dorë nga një imunitet nuk do të shtrihet në asnjë masë ekzekutimi ose bllokimi të pronës.

9. Godinat dhe mjediset e zyrës do të jenë të paprekshme. Pronat dhe pasuritë e saj do të kenë imunitet nga kërkimi, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose ndonjë formë tjetër ndërhyrjeje, nëpërmjet veprimit administrativ, juridik ose legjislativ. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë do të kenë të drejtën të hyjnë në mjediset e zyrës vetëm pas pëlqimit të shprehur apo me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës ose shefit të zyrës në Tiranë. Pëlqimi i këtyre të fundit do të merret i mirëqenë në rastet e zjarrit, përmytjes ose fatkeqësive të tjera natyrore.

10. Arkivat e zyrës dhe në përgjithësi i gjithë dokumentacioni që i përket ose që mbahet prej saj do të jenë të paprekshme kudo që të ndodhen.

11. Duke mos u kufizuar nga kontrollet, rregullat ose moratoriumet financiare të çdo lloji:

a) zyra mund të mbajë monedhë të çdo lloji dhe të përdorë llogari bankare në çdo lloj monedhe;

b) zyra mund të transferojë lirisht fondet e saj nga njëri vend në tjetrin ose brenda për brenda një vendi dhe të këmbëjë monedhën që ajo zotëron në çdo monedhë tjetër;

c) në ushtrimin e të drejtave të saj në bazë të nënparagrafëve të mësipërm “a” dhe “b”, zyra do t’i kushtojë vëmendjen e duhur çdo përfaqësimi të dhënë nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe do të respektojë këto përfaqësime deri në atë masë që ajo konsideron se mund të bëhet një gjë e tillë, pa dëmtuar interesat e zyrës.

12. Zyra, të ardhurat dhe prona të tjera të saj do të përjashtohen nga:

a) të gjitha tatimet e drejtpërdrejta, megjithatë zyra nuk do të ketë pretendime për t’u përjashtuar nga norma taksa apo detyrime, të cilat nuk janë gjë tjetër, veçse shpenzime për përdorimin e shërbimeve të objekteve publike;

b) të gjitha tatimet doganore, ndalimi dhe kufizimet në eksport-importe lidhur me artikujt e kërkuar nga zyra për përdorimin e saj zyrtar; artikujt e importuar në bazë të këtij përjashtimi nuk do të shiten në vendin nga i cili ato janë importuar, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë bëhet mbi bazën e kushteve të miratuara nga qeveria e atij vendi;

c) të gjitha tatimet doganore, ndalimi dhe kufizimet mbi eksport-importet lidhur me botimet e saj.

13. Për qëllime të komunikimit të tyre zyrtar, nëpunësit e zyrës do të gëzojnë një trajtim, të paktën po aq të favorshëm sa dhe trajtimi që Republika e Shqipërisë u bën misioneve diplomatike të çdo qeverie tjetër.

Ndaj korrespondencës zyrtare dhe dokumentacionit tjetër zyrtar të nëpunësve të zyrës nuk do të zbatohet asnjë censurë.

Zyra mund të përdorë kanalet, mjetet dhe shërbimet e komunikimit që kërkohen për të garantuar aftësinë e saj të plotë për komunikim. Në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve të Republikës së Shqipërisë, zyra mund të përdorë spektrin elektromagnetik për veprimet e saj, duke u angazhuar të bashkëpunojë me autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë për sigurimin e licencave. Zyra nuk ka të drejtë të përdorë frekuenca transmetimi.

Korrespondenca private dhe komunikimet e tjera që u drejtohen ose që burojnë prej tyre do të konsiderohen nga nëpunësit e zyrës si komunikim zyrtar i zyrës dhe si të tilla, ato do të përfitojnë nga dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi.

14. Nëpunësit e zyrës, me përjashtim të stafit të rekrutuar vendas, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) do të kenë imunitet nga procesi ligjor lidhur me fjalët e thëna ose të shkruara dhe të gjitha aktet e kryera, në cilësinë e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të autoritetit të tyre;

b) të përjashtohen nga tatimet mbi pagat dhe kompensimit që Këshilli i Europës u jep atyre;

c) së bashku me bashkëshortët dhe të afërmit në ngarkim të tyre, do të kenë imunitet nga kufizimet e imigracionit dhe regjistrimi i të huajve;

d) do t'u akordohen të njëjtat privilegje lidhur me lehtësitë e këmbimit valutor si ato që iu akordohen zyrtarëve të një rangu të krahasueshëm e që formojnë pjesë të misioneve diplomatike të qeverive në fjalë;

e) së bashku me bashkëshortët dhe të afërmit në ngarkim të tyre, do t'u bëhen të njëjtat lehtësi riatdhesimi në periudha krizash ndërkombëtare, kur ata shërbejnë si të dërguar diplomatikë;

f) do të kenë të drejtën e importimit pa taksë të orendive shtëpiake dhe sendeve personale gjatë kohës së paraqitjes për herë të parë në detyrë në vendin në fjalë, si dhe të riekportit sërish pa taksa gjatë kthimit në vendin e tyre të banimit.

15. Nëpunësit e zyrës, duke përfshirë edhe shtetas të vendit pritës, të cilët janë rekrutuar si staf i saj, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitete e parashikuara në nënparagrafët "14a" dhe "14b".

16. Privilegjet dhe imunitetet akordohen për nëpunësit e zyrës, në interes të Këshillit të Europës dhe jo për përfitime vetjake të këtyre individëve. Sekretari i Përgjithshëm do të ketë të drejtën dhe detyrimin për t'i hequr imunitetin çdo zyrtari në rastet kur se ai/ajo, sipas mendimit të tij/saj, gjykon se imuniteti pengon ecurinë e drejtësisë dhe pa paragjykuar interesin e Këshillit të Europës.

17. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet zyrës dhe personave privatë lidhur me livrimet e artikujve, shërbimet e kryera ose pasurinë e paluajtshme të blerë në emër të zyrës, do të paraqitet për arbitrim, në përputhje me dispozitat e një urdhri administrativ të lëshuar nga Sekretari i përgjithshëm dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave.

18. Funksionimi i zyrës do të financohet me të ardhurat e buxhetit të zakonshëm të Këshillit të Europës dhe në rastet kur mund të jetë e zbatueshme, edhe nga burime ekstrabuxhetore që do të akordohen për zbatimin e programeve të bashkëpunimit.

19. Zyra e nëpunësit e saj lejohen të tregojnë emblemën e Këshillit të Europës në mjediset që përdor zyra si dhe në mjetet e saj të transportit.

20. Në rastet kur zyra blen për përdorim të saj mallra ose shërbime me çmime të cilat përfshijnë taksa ose tatime të akcizës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të marrë masat e duhura administrative për kthimin ose rimbursimin e shumës përkatëse të këtyre taksave dhe tatimeve.

21. Veç dispozitave që përmban MPPI-së, nëpunësit e zyrës:

a) do të përjashtohen nga zbatimi i ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi sigurimin shoqëror;

b) do të pajisen, sipas rregullit, së bashku me bashkëshortët dhe të afërmit në ngarkim të tyre me leje qëndrimi për periudhën e qëndrimit të tyre në detyrë në Republikën e Shqipërisë.

22. Automjetet e Zyrës së Këshillit të Europës do të regjistrohen me targa diplomatike dhe do të kenë sigurimin e duhur ndaj palëve të treta.

23. Nëpunësit e zyrës do të respektojnë ligjet e vendit dhe nuk do të kryejnë veprimtari të papajtueshme me mandatin e tyre dhe detyrat e zyrës.

24. Livruesit e shërbimeve dhe konsulentët e kontraktuar në vend do të vazhdojnë t'u nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të vendit.

25. Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi mirëkuptimi do të zgjidhen me mjete diplomatike.

26. Zyra do të krijohet për një periudhë fillestare prej tre vitesh, në përfundim të të cilës Komiteti i Ministrave do të marrë një vendim lidhur me zgjatjen e termave të referencës së zyrës.

27. Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Këshilli i Europës do të njoftohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi. Ai do të vazhdojë të jetë i vlefshëm për një periudhë trevjeçare, duke filluar nga data e hyrjes së tij në fuqi.

28. Në rast se ky vendim i Komitetit të Ministrave do të merret përpara datës së skadimit, të parashikuar në paragrafin 27 për ripërtëritjen e termave të tij të referencës, ky memorandum mirëkuptimi do të shtyhet automatikisht dhe do të vazhdojë të jetë i vlefshëm deri në datën kur palët do të kenë përfunduar një protokoll mbi ripërtëritjen e këtij memorandumi mirëkuptimi. Këshilli i Europës do të njoftojë menjëherë Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi këtë vendim.

29. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë mund të shprehë kundërshtimin e vet ndaj zbatimit të dispozitave të paragrafit 28 në çdo periudhë kohe përpara datës së përfundimit të vlefshmërisë së parashikuar në paragrafin 27 duke njoftuar për këtë me shkrim Këshillin e Europës; në këtë rast, memorandumi i mirëkuptimit do të ndërpresë efektet e tij në datën e përfundimit të vlefshmërisë të parashikuar në paragrafin 27.

30. Gjatë periudhës trevjeçare të parashikuar në paragrafin 27 dhe në rastin e shtyrjes automatike të memorandumit të mirëkuptimit në zbatim të paragrafit 28, çdonjëra nga palët mund të përfundojë vlefshmërinë e këtij memorandumi mirëkuptimi duke njoftuar palën tjetër me shkrim. Ky memorandum mirëkuptimi do të pushojë së vepruari 6 muaj pas datës së dërgimit të këtij njoftimi te pala tjetër, me përjashtim të ndërprerjes së aktiviteteve të zyrës në Republikën e Shqipërisë. Në këtë rast, ky memorandum mirëkuptimi do të humbasë vlefshmërinë e tij me përfundimin e pranisë së zyrës në Republikën e Shqipërisë.

Nënshkruar në dy kopje në Strasburg më.....

**PËR KËSHILLIN E EUROPËS**

**Sekretar i Përgjithshëm**

**Thorbjorn Jagland**

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË**

**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiptotë**

**Përfaqësuese e Përhershme e Shqipërisë**

**në Këshillin e Europës**

**Margarita Gega**

**VENDIM**  
**Nr.156, datë 2.3.2011**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS  
“BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET  
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË  
“EL ER ENERGY” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “STOJAN”, TË  
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.1107, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në kontratën e koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “El Er Energy”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Stojan”, të miratuar me vendimin nr.1107, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 23.3.2011  
Doli nga shtypi më 25.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë